

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-008/2015
GSK-KPA-A-009/2015
GSK-KPA-A-013/2015
GSK-KPA-A-015/2015
GSK-KPA-A-019/2015**

**Prishtinë
10 Maj 2017**

Në çështjen juridike të:

Ž. C.
Gjilan

Përfaqësuar nga:

D. C. L.
Avokat nga fshati Bresje,
Fushë Kosovë

Pala Ankuese

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Sylejman Nuredini, kryetar i Kolegjit, Anna Bednarek dhe Beshir Islami, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesat kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm: “KKPK”) nr. KPCC/D/C/232/2014, të datës 13 mars 2014 (lëndët e regjistruara në Agjencinë Kosovare të Pronës me numrat KPA21559, KPA21560, KPA21564, KPA21566 dhe KPA29982), pas shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më 10 Maj 2017 mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Ankesat e paraqitura nga Ž. C. të regjistruara me numrat GSK-KPA-A-008/2015, GSK-KPA-A-009/2015, GSK-KPA-A-013/2015, GSK-KPA-A-015/2015 dhe GSK-KPA-A-019/2015, që kanë të bëjnë me lëndët e regjistruara në Agjencinë Kosovare të Pronës me numrat KPA21559, KPA21560, KPA21564, KPA21566 dhe KPA29982, bashkohen në një lëndë të vetme me numrin GSK-KPA-A-008/2015.
2. Ankesat e paraqitura nga Ž. C. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/C/232/2014, të datës 13 mars 2014, për sa i përket lëndëve të regjistruara në Agjencinë Kosovare të Pronës me numrat KPA21559, KPA21560, KPA21564, KPA21566 dhe KPA29982 hedhen poshtë si të palejueshme për shkak se janë paraqitur nga personi i paautorizuar.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 18 qershor 2007 dhe 19 qershor 2007, Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Kosmet Coning”, me seli në Novi Sad, Republika e Serbisë, (në tekstin e mëtutjeshëm: “paraqitësja e kërkesës”), e përfaqësuar nga Ž. P. C. (në tekstin e mëtutjeshëm: “pala ankuese”), si përfaqësues i autorizuar në pozitën e tij si drejtor i paraqitëses së kërkesës, ka paraqitur disa kërkesa në Agjencinë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtutjeshëm: “AKP”) ku kërkonte vërtetimin e të drejtave të saj pronësore mbi lokalet banesore dhe afariste dhe njësitë e tjera që ndodhen në disa kate të dy objekteve afariste: A dhe B, të cilat pretendohet se janë ndërtuar në ngastrat nr. 7476/1 dhe 7480, në Prishtinë, Rruga “Dvarska 6”, Dardanija, afër stacionit të autobusëve në Prishtinë (në tekstin e mëtutjeshëm: “pronat e kërkuara”).
2. Për të mbështetur kërkesat e saj, paraqitësja e kërkesës ka dorëzuar në AKP *inter alia* dokumentet si në vijim:
 - Aktvendimin për regjistrimit e biznesit, të datës 31 dhjetor 1999, të lëshuar nga Agjencia për Regjistrim Afarist e Republikës së Serbisë, ku paraqitësi i kërkesës ishte regjistruar me emrin e plotë Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar Kosmet Coning, për Planifikim, Punë Ndërtimore dhe Inxhinieri, Nr. 08201366, me seli në Novi Sad, Serbi. Pala Ankuese figuron si themelues dhe përfaqësues i paraqitëses të kërkesës (p.sh. f. 43 të dosjes 023/2015);
 - Aktvendimit nr. 351-363/93-01 të Asamblesë Komunale të Prishtinës mbi Ndarjen e Tokës Ndërtimore të Qytetit në Shfrytëzim (ngastrat e tokës 7471/1 dhe 7480), të datës 16 korrik 1993;
 - Aktvendimin e Sekretariatit për Urbanizëm dhe Ndërtimtari lidhur me miratimin e ndërtimit të objekteve të banimit dhe shërbimeve (Hyrja A, Katet Po+P+1+M, dhe hyrjen B, katet P+1+M) në ngastrat kadastrale 7476/1 dhe 7480 në Dardani në Prishtinë;
 - Autorizimin e legalizuar në Gjykatën Komunale të Kamenicës me Vr. Nr. 1165/08 me 1 tetor 2008, ku autorizohet avokati L. C. D. për të përfaqësuar palën ankuese.
 - Certifikatë mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshme, të datës 24 qershor 2011, që konstaton se ngastrat nr. 7476/1 dhe 7480 janë të regjistruara në emër të Komunës së Prishtinës.

3. AKP-ja identifikoi Kërkesën KPA21599 dhe KPA21560 me 20 Shkurt 2008, Kërkesën KPA21564 dhe KPA21566 me 15 Shkurt 2008 dhe Kërkesën KPA29982 me 17 Janar 2012. Korporata Energjike e Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm: KEK) pretendoi të jetë pronare e 15 apartamenteve në lidhje me Kërkesën KPA21559. Pretendimin e tij e bazon në Kontratën mbi Ndërtimin e lidhur ndërmjet KEK si investitor dhe Kosmet Coning si kryes i punimeve. Megjithatë, detalet që përfshihen në Kontratën për Ndërtimin nuk korrespondojnë me pronat e kërkuara. Asnjë Palë tjetër nuk iu është bashkangjitur procedurave pranë AKP-së.
4. Sekretaria Ekzekutive e AKP-së kishte verifikuar pozitivisht dokumentet e cekura në paragrafin 2 dhe për më tepër kishte gjetur ex officio, dokumentin e poshtëshënuar:
 - Aktvendimin e Gjykatës Ekonomike në Novi Sad (Republika e Serbisë) Nr. 139/2011, të lëshuar me 1 gusht 2011, në bazë të cilës vërtetohen arsyet që shpjen në falimentimin e paraqitëses së kërkesës. Sipas dispozitivit, procedura e falimentimit ishte iniciuar për shkak të pamundësisë së përhershme për të paguar borxhet. Gjithashtu, theksohet se kreditorët dhe debitori nuk kanë interes ligjor për të zbatuar procedurën e falimentimit. Procedura e falimentimit ishte kryer dhe prona e debitorit, nëse kishte, sipas ligjit ishte bartur nën pronësi të Republikës së Serbisë.
5. Sekretariat Ekzekutive e AKP-së gjeti se Gjykata Kushtetuese e R së Serbisë përmes vendimit të datës 17 Korrik 2012 gjeti se dispozitat për falimentimin e Paraqitëses se Kërkesës ishin jo kushtetuese. Ky Vendim ishte botuar ne Gazetën Zyrtare të R. së Serbisë me 25 Korrik 2012, pothuajse një vit pas falimentimit të Paraqitëses së Kërkesës , duke ngritur kështu çështjen e karakterit prapaveprues të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese të Serbisë. Nga provat në dispozicion konstatohet se Pala Ankuese nuk kishte paraqitur propozim për rishikimin e vendimit brenda afatit të caktuar.
6. Më 5 mars AKP-ja kishte njoftuar Komunës e Prishtinës në lidhje me Kërkesat; megjithatë komuna e cekur nuk kishte paraqitur përgjigje.
7. Sekretaria Ekzekutive e AKP-së kishte siguruar informacionin se vendimi i Gjykatës Ekonomike në Novi Sad ishte i plotfuqishëm dhe detyrues që nga data 11 nëntor 2011 dhe se paraqitësja e kërkesës ishte shlyer nga Regjistri i Bizneseve në Republikën e Serbisë dhe se ajo nuk ekzistonte më.
8. Gjithashtu, në bazë të deklaratës së vet palës ankuese dhe pas hulumtimit në regjistrat e subjekteve juridike, pala ankuese nuk ishte e regjistruar si subjekt afarist në Kosovë.
9. Më 13 mars 2014, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës përmes vendimit të saj KPCC/D/C/232/2014 (në tekstin e mëtejme: “Vendimi i KKPK-së”) kishte hedhur poshtë kërkesat. Në arsyetimin e vendimit, KKPK-ja kishte vërejtur se kërkesat ishin paraqitur nga subjekti juridik “Kosmet Coning” Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar me selinë e saj të regjistruar në Republikën e Serbisë, në cilësinë e saj si bartës i pretenduar i të drejtës pronësore. Paraqitësja e kërkesës ishte përfaqësuar nga përfaqësuesi i saj i autorizuar në mënyrë të rregullt, duke qenë në të njëjtën kohë i vetmi aksionar i Shoqërisë. Sekretaria Ekzekutive e AKP-së kishte vërtetuar se paraqitësja e kërkesës kishte shpallur falimentimin në vitin 2011 dhe më pastaj ishte fshirë nga regjistri i shoqërive afariste. Rrjedhimisht, paraqitësja e kërkesës kishte pushuar së ekzistuari si palë në procedurën para KKPK-së. Komisioni më tej konstatoi, se “pasi që paraqitësja e kërkesës si Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, posedonte subjektivitetin e saj juridik ndaras nga pronarët e saj (aksionarët), aksionari i cili i kishte paraqitur këto kërkesa në Komision në emër të paraqitëses së kërkesës nuk mund të njihet si trashëgimtar ligjor i paraqitëses së kërkesës lidhur me të drejtat e pretenduara pronësore”.

10. Vendimi i KKPK-së i ishte dorëzuar palës ankuese më 16 korrik 2014. Më 14 gusht 2014 ai kishte paraqitur ankesat kundër Vendimit të KKPK-së lidhur me kërkesat të cekura më poshtë:

Numri i ankesës dhe numri i lëndës së AKP-së	Të dhënat lidhur me ngastrën e kërkuar	Numri dhe data e vendimit
<i>GSK-KPA-A-08/2015 (KPA21559)</i>	<i>Ngastra 7476/1 dhe Ngastra 7480, Prishtinë, Drvarska 6, në sipërfaqe prej 20 m²</i>	<i>KPCC/D/C/232/2014 Dt. 13 mars 2014</i>
<i>GSK-KPA-A-09/2015 (KPA21560)</i>	<i>Ngastra 7476/1 dhe Ngastra 7480, Prishtinë, Drvarska 6, në sipërfaqe prej 20 m²</i>	<i>KPCC/D/C/232/2014 Dt. 13 mars 2014</i>
<i>GSK-KPA-A-013/2015 (KPA21564)</i>	<i>Ngastra 7476/1 dhe Ngastra 7480, Prishtinë, Drvarska 6, në sipërfaqe prej 20 m²</i>	<i>KPCC/D/C/232/2014 st. Dt. 13 mars 2014</i>
<i>GSK-KPA-A-015/2015 (KPA21566)</i>	<i>Ngastra 7476/1 dhe Ngastra 7480, Prishtinë, Drvarska 6, në sipërfaqe prej 20 m²</i>	<i>KPCC/D/C/232/2014 st. Dt. 13 mars 2014</i>
<i>GSK-KPA-A-019/2015 (KPA29982)</i>	<i>Ngastra 7476/1 dhe Ngastra 7480, Prishtinë, Drvarska 6, në sipërfaqe prej 20 m²</i>	<i>KPCC/D/C/232/2014 st. Dt. 13 mars 2014</i>

Pretendimet e palës ankuese

11. Pala ankuese thekson se vendimi i KKPK-së përmban gabim thelbësor apo zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe asaj procedurale të aplikueshme, si dhe mbështetet në vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike sepse pala ankuese është pronar i paraqitëses së kërkesës dhe njëkohësisht pronar i pronave të kërkuara. Sipas mendimit të palës ankuese, fakti që Shoqëria nuk ekziston më si subjekt juridik mbetet pa ndonjë ndikim për rezultatin e rastit në fjalë pasi që pronat e kërkuara janë prona private të palës ankuese. Së bashku me ankesën, Ž. C. ka dorëzuar autorizimin që i kishte dhënë avokatit Dobrica Lazić për ta përfaqësuar atë para AKP-së.

Bashkimi i ankesave

12. Sipas nenit 13.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, Gjykata Supreme mund të vendos mbi bashkimin apo shkrirjen e ankesave, kur një bashkim

apo shkrirje e tillë e kërkesave është vendosur nga Komisioni në përputhje me nenin 11.3 (a) të ligjit. Me këtë dispozitë ligjore parashihet bashkimi i i kërkesave kur ekzistojnë çështje të përbashkëta sikundër të bazës faktike ashtu edhe ligjore.

13. Dispozitat e Ligjit mbi Procedurën Civile që janë të aplikueshme në procedurën para Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme në përputhje me nenin 12.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, si dhe dispozitat e nenit 408.1 lidhur me nenin 193 të Ligjit nr. 03/L006 mbi Procedurën Kontestimore, parashohin mundësinë e bashkimit të të gjitha kërkesave përmes një aktvendimi nëse kjo do të siguronte efektivitetin dhe efikasitetin e gjykatës lidhur me lëndën.
14. Në tekstin e ankesave të paraqitura nga pala ankuese, Gjykata Supreme vëren se përveç numrit të ndryshëm të lëndës për të cilën ankesa përkatëse është paraqitur, faktet, baza ligjore dhe çështjet e provave janë tërësisht të njëjta në të gjashtë rastet. Vetëm ngastrat, subjekt i të drejtës pronësore e cila pretendohet në secilën kërkesë, janë të ndryshme. Ankesat bazohen në deklaratën e njëjtë shpjeguese dhe mbi dokumentacionin e njëjtë. Gjithashtu, arsyetimi ligjor i KKPK-së për kërkesat është i njëjti.
15. Prandaj, ankesat e regjistruara me numrat GSK-KPA-A-008/2015, GSK-KPA-A-009/2015, GSK-KPA-A-013/2015, GSK-KPA-A-015/2015 dhe GSK-KPA-A-019/2015, bashkohen në një lëndë të vetme me numrin GSK-KPA-A-008/2015.

Arsyetimi ligjor

16. Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, pretendimeve të Palës Ankuese dhe vlerësimit të Vendimit ankimor sipas dispozitës së nenit 194 lidhur me nenin 95 të Ligjit për Procedurën Kontestimore Nr. 03/L-006 (në tekstin e mëtuftjeshëm LPK-së), Gjykata Supreme gjeti se ankesat e lartpërmendura të Ž. C. duhet të hedhën poshtë si të palejueshme sipas nenit 186.3 në lidhje me nenin 95 të LPK-së shkak të faktit se Pala Ankuese nuk është e autorizuar ti paraqes ankesat.
17. Paraqitësja e kërkesës: “Kosmet Coning” Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar nga Novi Sadi (në tekstin e mëtejme: “Shoqëria”, “sh.p.k-ja”, “subjekti juridik”), e përfaqësuar nga Drejtori Ž. C. ka kërkuar nga AKP-ja të vërtetoi të drejtat e saj pronësore mbi pronat e kërkuara dhe ri-posedimin e tyre. Megjithatë, gjatë procedurës, para se KKPK-ja të lëshonte vendimin, subjekti juridik ishte shlyer nga Regjistri nga Gjykata Ekonomike në Republikën e Serbisë, kështu që sh.p.k-ja kishte pushuar së ekzistuari. Rrjedhimisht, Komisioni kishte hedhur poshtë kërkesat e paraqitura nga Shoqëria dhe kishte sqaruar se aksionari i cili kishte paraqitur kërkesat në emër të subjektit juridik nuk mund të njihet si trashëgimtar ligjor i paraqitëses së kërkesës. Vendimi më pastaj i ishte dorëzuar Ž. C, i cili kishte paraqitur ankesat, në të cilat ai kishte pretenduar se ai kishte qenë pronar i pronave të kërkuara mbi bazën e kontratës të lidhur në vitin 1999, si dhe kishte deklaruar se duke qenë aksionar i të gjitha aksioneve të Shoqërisë, ai kishte qenë pronar i të gjitha pasurive të saj.
18. Sipas nenit 12.1 të Ligjit nr. 03/L-079 “brenda tridhjetë (30) ditëve të njoftimit të palëve në Agjencinë Kosovare të Pronës për vendimin e Komisionit mbi kërkesën, pala mund të dorëzoj përmes Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës në Gjykatën Supreme të Kosovës ankesë kundër një “vendimi të tillë”. Në rastin konkret ka qenë vetëm një palë në procedurë: “Kosmet Coning”, Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar nga Novi Sadi. Fakti se sh.p.k-ja pasi që u deklaruar si e falimentuar ishte shlyer nga Regjistri i bizneseve do

të thotë se paraqitësi i kërkesës pushoi së ekzistuari. Komisioni veproi drejtë kurkishte vlerësuar se në një rast të tillë kërkesa duhet të hidhej poshtë.

19. Pala ankuese Ž. C. gjatë procedurës nuk kishte vepruar si person fizik, në emër të tij, por kishte përfaqësuar subjektin juridik. Pasi që pala në procedurë falimentoj, ajo nuk mund të përfaqësohet më as nga drejtori dhe as nga ndonjë përfaqësues tjetër (neni 95.2 të LPK-së). Asnjëra nga dispozitat e ligjit në fuqi në Republikën e Kosovës nuk e lejon që përfaqësuesi i përparshëm i subjektit juridik të futet në procedurë në emër të e tij pas shpalljes së falimentimit, dhe as nuk lejon që një përfaqësues i tillë të bëhet trashëgimtar i Shoqërisë. Për më tepër, pala ankuese i cili paraqiti kërkesat në emër të sh.p.k-së nuk kishte ndryshuar përmbajtjen e ankesave gjatë procedurës para KPPK-së sipas nenit 257-261 të LPK-së. Për këto arsye Ž. C nuk mund të konsiderohet si palë në procedurë në rastin konkret, kështu që ai as nuk kishte mundur të paraqesë kërkesat në emër të tij e as të paraqesë ankesë kundër Vendimit .
20. Prandaj ankesat janë hedhur poshtë si të papranueshme për arsye procedurale (neni 13.3(b) të Ligjit nr. 03/L-079). Rrjedhimisht Gjykata Supreme nuk ka mundur të shqyrtoj bazën e cekur në ankesa.

Këshillë ligjore

Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin Nr 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Sylejman Nuredini, kryetar i Kolegjit

Anna Bednarek, gjyqtare e EULEX-it

Beshir Islami, gjyqtar

Sandra Gudaityte, Referente e EULEX-it